




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO.
Nr. No. Qr. 02/421.
23/10/2024

PROCESVERBAL

i mbledhjes së - V- (pestë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

Mbledhja u mbajt me datë: 13.06.2024 dhe filloi në ora: 13:15.

Në mbledhje morë pjesë: 19 asambleistë, Kryesuesi Argjend Thaçi, drejtorë komunal: Sylë Dukolli, Bashkim Krasniqi, përfaqësuesi nga OSBE-së dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Hapi mbledhjen e -V- (pestë) të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Prezent në mbledhje jemi 19 antarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes.

Mirëllinda Gashi (anëtare nga PDK): Unë kam një pyetje, Komuna a nuk ka ujë, sepse sot nuk ka ujë në tualete në komunë. A është problemi i rrymës?

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Së pari ju uroj ditën e Çlirimit në nivel Republike dhe uroj Amrushin për performancën që e ka treguar si anëtar i kuvendit. Amrush, ne jemi krenar që të kemi si anëtar të grupit tonë të NISMA-s dhe të inkurajoj me i vazhdu këto aktivitete, sepse në radhë të parë i kontribon vetës tënde, partisë, kuvendit dhe shoqërisë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Në kuadër të aktiviteteve të kuvendit të komunës kemi asambleistin dhe asambleisten më të mirë. Po e shfrytëzoj rastin ta uroj Amrushin si asambleisti më i mirë ose më aktiv dhe nga gjinia femrore Agnesë Kastrati. Urime!

Kourum kemi dhe mund të vazhdojmë me punimet. Me leje mungon Valjetë Hoti, Gentianë Hoti, Agnesë Kastrati dhe Veton Zogaj. Kalojmë tek rendi i ditës. Tek rendi i ditës propozoj që të futet Raporti i komitetit për barazi gjinore. Nëse nuk ka diskutues për rend të ditës e hedhin ë votim Raportin e barazis gjinore.

Kush është për që të futet në rend të ditës Raporti për Barazi Gjinore?

Me vota unanime të 20 antarëve, kjo pikë hynë ne rend të ditës.

Kush është për këtë rend të ditës?

Me vota unanime të 20 anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/682 datë:06.06.2024, të Këshillit Organizativ për ndarjen e mirënjohjeve për nderë të 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
- 2.Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2024.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/179 datë:19.04.2024.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 datë:21.05.2024.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1409 datë:26.10.2023.
- 6.Raporti i komitetit për barazi gjinore
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/682 datë:06.06.2024, të Këshillit Organizativ për ndarjen e mirënjohjeve për nderë të 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Këshilli Organizativ i formuar me vendimin e Kuvendit, pas shqyrtimit të propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit, vendosi që në pajtim me nenin 9 të Statutit të komunës së Malishevës t'i propozojë këto personalitete për ndarjen e çmimeve si në vijim:

Këshilli Organizativ i propozon Kuvendit për miratim këto çmime: për çmimin “Imer Krasniqi”, këshilli organizativ vendosi ti dërgoj në kuvend propozimet e Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare, dega në Malishevë: Mehmet Kastrati (pas vdekjes), Njazi Krasniqi (pas vdekjes). Për çmimin “Hamdi Berisha”, për kontributin e dhënë në shkollën shqipe propozon Bajram Samadraxhen (pas vdekjes) dhe Sherif Elshani.

Për çmimin “Shpëtim Robaj”, për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë propozon Sadije Thaçi (pas vdekjes) dhe Sehrije Bujupi-Gashi.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Uroj të gjithë qytetarët për ditën e Çlirimit 16 qeshorin. Ne si Këshill kemi mbajtur takimin, kemi diskutuar dhe kemi rekomanduar emrat të cilët duhet të marrin aprovimin nga Kuvendi. Ne formalisht jemi dakorduar dhe jemi pajtuar, përveç tek pika e arsimit që kemi pasur disa kundërshtime dhe zakonisht gjithmonë tek ajo pikë po kemi mospajtime, sepse çdo herë po bëhen politike, po japin kahje politike sesa meritore ose profesionale. Ne në parim i mbështesim të gjitha këto çmime.

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit të gjithë dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të luftës dhe të gjithë atyre që kanë kontribuar në diasporë për financimin e luftës dhe deri tek ai që ka ndikuar me një fjalë të vetme kanë kontribuar për çlirimin e vendit tonë. Ne si grup votojm pro këtyre propozimeve të dhëna nga ky Këshillë.

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Ne si grup i mbështesim propozimet e ardhura nga ky Këshillë. Jemi në data festive andaj urime 16 qeshori dita e Çlirimit!

Labinot Gashti (anëtar nga LDK): Urime dita e Çlirimit të gjithë qytetarëve!
Shumica e asambleistëve kanë të njëjtin shqetësim, që pasi erdhëm në seancë tek ne erdhe materiali me biogravfit e të propozuarve nga Këshilli Organizativ. Ne e kemi miratuar një Statut të Komunës së Malishevës, ku dhe unë kam qenë anëtar, e kemi propozuar që tek qështja e çmimeve kur ka pasur shumë telashe të tilla dhe realisht këto çmime i ndan kuvendi, por kuvendi nuk është duke ndar çmime, këto çmime i propozojnë shoqatat. Unë e kam propozuar dhe në Komision të Statutit, që kjo më mirë është përmes thirrjes publike që secili me pas të drejtën me propozu me afat të caktuar emrat me biografi dhe ai Komision me i shqyrto dhe jo ne të vimë para një akti të krym. Shqetësim tjetër është mungesa e materialit në email.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës nr.01/682 datë:06.06.2024, të Këshillit Organizativ për ndarjen e mirënjohjeve për nderë të 16 Qershorit- Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës?

Për:18

Kundër: 0

Abstenim: 2

Kompenzimi i këtyre personaliteteve është 200E për secilën anëtarë që e merr çmimin. A dëshironi ta ndryshoni kompenzimin apo e lejëmë ashtu siç është.

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Sa i përket kësaj qështje, këto çmime jepen për nderim dhe jepet një shumë simbolike. Nuk është esenca kryesore e këtyre çmimeve tek aspekti financiar. Unë mendoj që mos ta ndryshojmë.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Peronaliteteve që ju kemi ndarë çmime vitin e kaluar, a ju kanë alokuar mjetet. Këtu kemi përfitues të çmimeve pas vdekjes, mjetet duhet të shkojnë për një person tjetër, sepse vendimi nëse ndahet në bazë të kësaj do ketë telashe procedurale me i ekzekutu pagesat. Kryesues, obligimet duhet të kryhen me kohë.

Valon Krasniqi (anëtar nga Lista Guxo): Kryesues, këto çmime përderisa ne si kuvend i votojmë dhe ti të jesh me vizhilent dhe kur të jepen të ndahen nga ana juaj, për shkak se jeni kryesues i kuvendit dhe kryetari Kastrati dhe jo figurat e tjera që nuk përfaqësojnë asgjë në Kuvend.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Secila parti politike në këtë kuvend i ka anëtarët e vetë të përfaqësuar aty në Këshillë.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Është për keqardhje që nuk janë paguar ata që janë nderu me ato çmime vitin e kaluar. Sa i përket ndryshimit të vlerës ose të jetë 200 siç është ose nëse dëshirojmë ta ndryshojm vlerën, po e bëjmë me nga 500E.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Nese jeni për 200 E nuk kemi nevojë ta votojmë.

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Në rend të ditës nuk e kemi pasur ndryshimin e vlerës.

Pika e dytë

2. Shqyrtimi i Planit të Prokurimit për vitin 2024

Kryesuesi Argjend Thaçi: Prezent nuk e kemi asnjë përfaqësues nga zyra e prokurimit.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Kjo është pa përgjegjësi totale, sepse ka mospërputhje, ka vlera që janë të përsëritura dy herë, ka vlera të fryera trefish dhe për faktin që mungon përfaqësuesi nga prokurimi këtu lenë shumë dyshime që ka keqpërdorime të mëdha dhe nuk mundet me i arsytu. Dikush duhet të japë përgjegjësi për këto gjëra.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Për pikat për të cilat nuk janë përfaqësuesit e atyre pikave prezent, mos të diskutojm në kuvend.

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Me Rregullore deri në mars duhet me raportu zyra e prokurimit dhe ne jemi në muajin qeshor. Nëse dikush këtu ngreh dyshime mbi keqpërdorimet janë shumë mënyra që ato dyshime me i vërtetu. Një kërkesë me shkrim ose një email dhe merr përgjigje

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Ne këtu jemi asambleista dhe fjala jonë që e themi këtu besoj që duhet të shkojë dhe të merret parasysh nga ekzekutivi. Unë dhe vitin e kaluar konkretisht nga Fatmir Ademaj dhe seancën e kaluar kam kërkuar që të na sillet lista e këtyre të punsuarve konsulent dhe asnjëherë nuk kemi marr përgjigje. Unë e bëjë një kërkesë nuk është problem, mirëpo ku po jetë kompetenca ime, ose mandati im si përfaqësues.

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Sa i përket Planit të Prokurimit unë kam insistuar që ky Plan të vijë në shkurt ose në mars, qfarë rëndësie ka debati jonë sot. Të gjitha këto që janë planifikuar janë në proces të tenderimit. Ne si kuvend kemi të drejtë me ndërhy sepse jemi të zgjedhur të popullit. Shumica e projekteve janë të përsëritura, të bartura- kanalizimi në Kijevë nga viti 2016 është dhe këtu nuk figuron. Si po gjejnë buxhet një projekt i ri me hy në vitin 2024 e nuk po ka buxhet me hy një projekt i vitit 2016. Ndërtimi i sallës të edukatës fizike në shkollën "Lasgush Poradeci" nga viti 2016, 100.000 mos të shkojnë mjetet suficid, prapë nuk ka gjetë zbatim në plan të prokurimit dhe shumë projekte të tjera të cilat nuk kanë gjetë zbatim.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Salla e sportit në shkollë në Kijevë nuk është në buxhet në vitin 2016, ai projekt ka hyrë në buxhet në vitin 2020-2021. Projekti i kanalizimit në Kijvë- ka shumë kanalizime që janë kryer në Kijevë.

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Projektet janë të bartura nga viti 2016. Ka kanalizime që kanë shkuar nëpër prona private dhe problemi në Kijevë nuk është heq. Salla sportit është hyrë për të dytën herë në vitin 2021. Ne vazhdimisht e kemi bërë atë kërkesë që kanalizimi me u lidhë

me pikën kryesore. Si gjenë zbatim një projekt që është futur në këtë vit dhe nuk është kryer tjetri para 8 viteve.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Kush e mban përgjegjësin që kjo është vonuar? Është seanca e dytë që kjo pikë futet në rend të ditës. Trotuarët e fshatit Bubël, Damanek ata janë shtruar më herët.

Sylë Dukolli (Drejtori për Bujqësi): Sa i përket projekteve që tha Labi, në vitin 2021 ka hyrë projekti i sallës së sportit, duhet të bëhen do plane, skicime për me dalë fusha mirë, sepse në njërën anë ngushtohet nga çerdhja ndërsa në pjesën tjetër ngushtohet nga shkolla. Kanalizimet nuk janë copy paste siç tha Albani, mirëpo kur të bëhet planifikimi i buxhetit në kanalizime duhet të shkojë me fshatra dhe 2200m brenda dy viteve janë shtruar në Kijevë. Sa i përket kanalizimit atë janë duke e bërë dy komuna, sepse nuk e përballon buxheti i komunës së Malishevës si e vetme, për shkak të rrjedhjes që e kanë dhe fshatrat e Klinës.

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Është e vërtet që janë bërë ato kanalizime, por nuk e kanë zgjidh problemin. Ne vazhdimisht e kemi bërë atë kërkesë që kanalizimi mu lidh në pikën kryesore. Si gjen zbatim një projekt që është fut sivjet dhe nuk është përfunduar një projekt para tetë viteve

Halil Morina (anëtar i Nisma Socialdemokrate): Kur flasim për planifikim, ka ndonjë punë që është hyrë në buxhet në vitin 2016 nuk është kryer, mirëpo në momentin që është përmbyllë ai vit buxhetor ai më nuk është projekt, ka dështu.

Pika e tretë

3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/179 datë:19.04.2024

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kemi të bëjmë me kërkesën për marrjen e pëlqimit për ripërkufizimin e kufijëve të parcelës, në të cilën është ndërtuar objekti afarizëm dhe banim, shfrytëzuesi i përhershëm i të cilës është Organizata e Pensionistëve.

Bashkim Krasniqi Drejtori për Geodezi, Kadastër dhe Pronë: Është një kërkesë e paraqitur nga investitori që së bashku me një marrveshje që e kanë bërë me organizatën e pensionistëve, kanë bërë investimin në parcelën e cila është ndarë nga Kuvendi i Malishevës. Problemi i këti ndërtimi është sepse nuk është respektu kuvendi që e ka pas. Nuk kërkohet rritje e parcelës por vetëm ripërkufizim që ai objekt me qenë brena atyre kufijve. Nuk dëmtohet askush sepse nuk ka pronë private, është pronë publike.

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Është mirë që një pjesë e këti objekti i atribuohet shoqatës së pensionistëve. Konsideroj që është mirë me e mbështetë, por për ripërkufizimin e kufijve është e njëjta sipërfaqe dhe nuk është ndonjë problem sepse e paska vendimin e kuvendit.

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Meqenëse nga ky vendim asgjë e dëmshme as të pronës publike dhe as private nuk ndodh, unë nuk po shohë ndonjë arsye pse mos me u votu kjo kërkesë. Ne si grup votojmë pro kësaj kërkesë.

Alban Kastrat (anëtar nga PDK): Çka do të bëjë ai investitori aty?

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Është përfundu ndërtimi, vetëm ballkoni ka dalë jashtë vies, dhe për me kry legalizimit duhet me hy brena vijes.

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): Grupi nga PDK e mbështetë këtë kërkesë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/179 datë:19.04.2024?
Për:18 Kundër:0 Abstenim:2

Pika e katërt

4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/209 datë:21.05.2024

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kemi të bëjmë me lejimin e vendosjes së lapidarit.

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Prona është e ekonomisë së pyjeve dhe ata kërkojnë me vendos një lapidar për rënjen e një qytetari në kohën e ishjugosllavis. Pelqimin komuna ja ka dhënë mirëpo ekonomia e pyjeve ka thënë që është procedurë që duhet të trajtohet përmes asamlesë dhe asamblea me shpronësu këtë pjesë prej 2 ari, me dërgu në qeveri me marr lejen dhe të qeveris dhe pastaj me pas të drejtën pas 4 viteve me ja dhënë të drejtën me vendos lapidarin. Është procedurë e rregullur me ligjin për pyje dhe ligjin për këmbimin e pronës publike.

Mirëlinda Gashi (anëtare nga PDK): Pse këtë nuk e bënë kryetari?

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Kuvendit): Ligji thotë që kuvendi duhet me votu me i marr dy ari me bërë zonë me interes publik dhe pas vendimit të asambles shkon në Ministrin e pushtetit Lokal. Konfirmohet ligjshëmëria, kthehet pastaj kryetari kërkon nga qeveria përmes MAPL-së që ata dy ari me i vendos në emër të kuvendit komunal.Pasi prona të vendoset në emër të kuvendit pas katër viteve komuna ka të drejtë me dhënë lejen me ndërtu lapidarin.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina(anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne si anëtarë të Kuvendit nuk kemi pse me qenë kundër për shpallje me zonë të veçantë për vendosjen e një lapidari. Kërkesa është bërë në emër të ish kryetarit, sepse ne jemi dëshimtar që fshati në fjalë nuk ka një këshill lokal për shkak të qështjes që ka qenë në proces gjyqësor kuvendi zgjedhor që është mbajt atje dhe sipas disa informacioneve nuk është jë pajtueshmëri e fshatit në përgjithësi për këtë qështje. Meqenëse ne e kemi këtë situat unë kisha propozu që pala kërkuese të merr nënshkrimet e gjithë përfaqësuesve të lagjeve ose qytetarëve të ati fshati. Ose të vijë kur të formohet këshilli i ri lokal të vjen kjo kërkesë në emër të ati këshilli me një peticion të pajtueshmërisë së qytetarëve të ati fshati. Nëse ka një pajtueshmëri të qytetarëve të ati fshati ne do votojmë pro kësaj kërkesë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pajtohem me Halilin, që është mirë që këto raste të kenë pajtueshmërin e Këshillit lokal duke pas parasysh që kërkesa që tani po e trajtojmë është bërë nga një Këshill lokal dhe konsiderohet që nuk ka një pajtueshmëri totale në mes banorëve është mirë që mos me miratu këtë qoftë pozitiv apo negativ, por me shty për një mbledhje të ardhshme.

Kryesusi Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda Gashi!

Mirëllinda Gashi (anëtare nga PDK): Zakonisht kur janë ardhur këso kërkesa unë kam kërkuar pëlqimin e fshatit. Unë kisha thënë me votu dhe me ecë përpara, sepse kemi dhënë dhe kemi bërë këso lëshime dhe herave të kaluara. Meqenëse është vetë investitor, unë mendoj me përkrahë, të shkon në Ministri dhe nëse e kundërshtojnë ata le të jetë nga ta. Kur kryetari i komunës ja ka dhënë të drejtën me vazhdu përpara pse ne po e kundërshtojmë. Nuk e di pse jeni kundër kësaj kur investitor është vetë familja. Unë personalisht jam për.

Kryesusi Argjend Thaçi; Urdhëro, Astrit!

Astrit Sertolli (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë pajtohna me kolegen, nuk e kam të qartë kërkesen dhe realisht nuk e kam të qart arsyt e kërkeses pse është dëshmor, a është i rënë në luftë apo është vetëm për dëshirën e tyre ta bëjë një lapidar dhe a ka hapsirë të vetën komuna ku mundet me ndërto apo duhet patjetër në atë parcelën atje me ndërto. Na shpjegoni pak këtë pjesë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Kryesues, kisha kërkuar që ta hudhësh në votim propozimin tim, që kjo që është të shtyhet deri të kompletohet dosja me petitionin dhe pelqyshmërin e qytetarve, qoftë të asaj lagje ose fshatit në përgjithësi.

Kryesuesi Argjend Thaçi: E hudh propozimin e Halilit që pika e rendit të ditës të shtyhet deri sa të kompletohet dosja brenda banorëve të lagjes. Kush është për që kjo pikë të shtyhet?

Për: 17

Kundër: 5

Abstenim: 0

17vota për, 5 kundër dhe asnjë abstenim kjo pikë shtyhet për një mbledhje tjetër.

Pika e pestë

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës numër 01/1409 datë 26.10.2023.

Ne si banorë të lagjes së re i drejtohem kryetarit të komunës së Malishevës që të na përkrahë apo të na mbështet për kyqjen në rrjetin elektrik, pasi që KEDS ka kërkuar shumën prej 12.000E, shumë e pa përballueshme nga ne banorët e kësaj lagje. Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Se di sa është e arsyeshme me ju drejtu kuvendit, përderisa është një institucion i cili është kompetent për zgjerimin e rrjetit të energjisë elektrike. Ata një kërkesë të ngjajshme e kanë pasur dhe për ujë. Ne paguajm dhe ujin dhe tarifën e kanalizimit dhe asnjë investim nuk është nga kompania. Gjitha kanalizimet i ka kry komuna. Ky kuvend dhe kjo komunë duhet me ditë deri ku i ka mundësit. Unë personalisht konsideroj që kërkesa të tilla të ngjajshme mos të vinë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pajtohem plotësisht me atë që e tha Valoni. Kompania KEDS e ka rrjetin menaxherial dhe e ka për detyrë me mirëmbajt atë rrjet. Janë 15 familje dhe KEDS nuk e dërgon rrjetin. Unë nuk dua ta përsërit një skandal që ka ndodh në mandatin e kaluar nëse ju kujtohet dikujt këtu, kemi pas marrë një vendim për ti ndihmuar 9000E (nëntë mijë) me vendos një trafë apo me dërgu rrjetin, dhe qka bëhet me ato mjete KEDS-i e paguan rrjetin me mjete të veta dhe ato 9000E shkojnë nëpër gjepa të njerëzve. Unë nuk po dëshiroj me i dhënë mundësi për me përsëritë këtë lloj skandali. Sigurisht që për mua është shqetësuese që 15 familje nuk janë të kyqura në rrjetin elektrikë por unë konsideroj kryetari i Komunës ti bëjë presion ati drejtorit të KEDSIT që është në Malishevë dhe me na jap një arsyetim pse një lagje nuk i dërgon rrjetin që kushton 12,000E, ku ato shtëpi për një kohë shumë të shkurtër kanë me i shpenzuar aq energji dhe do ti kthejnë ato mjete. Unë konsideroj se duhet të bëhej presion në KEDS për ti kyqur ato familje, presion dhe nga ana e jonë, ti si kryesues dhe kryetar i komunës ta bëjmë një takim me drejtorin e KEDSIT se pse nuk janë kyqur një lagje e tërë në rrjet. Sot nuk po marrim asnjë lloj vendimi pa u konsultuar dhe me na dhënë një arsye të fortë pse KEDSI nuk i kyq ata qytetarë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro Rukije!

Rukije Bytyqi (anëtare nga Nisma Socialdemokrate): Unë mendoj që këtyre familjeve meqenëse po kërkojnë ndihmë nga ne duhet tja japim një ndihmë. E di që komuna nuk mundet me ja mbulu shumë por të jetë një shumë simbolike. Unë kam biseduar me ata qytetarë dhe më kanë treguar se nuk kanë lënë derë pa trokitur, mirëpo KEDSI nuk i ka bërë zgjidhje. Kështu që ata meqenëse ata kanë kërkuar ndihmën unë mendoj se kjo ndihma jonë pak ja kish lehtësuar atyre dhe me kontributin e tyre për ta pasur një rrjet dhe një jetë sa më të mirë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro Alban!

Alban Kastrati (anëtar nga PDK): KEDS-i e ka për obligim për ti ofruar shërbime qytetarëve edhe pse ne tarifat shumë shtrejtë jemi duke i paguar, tani ne dhe rrjetin me ja dërgu qytetarve dhe ai vetëm taksat me i marrë. Kjo mos po bëhet një praktikë e keqe që po na jetë si ves dhe ne duhet ta vazhdojmë këtë. Unë mendoj sikur Halili, që kryetari është dashur për ta mbajtur një takim me menaxherin e KEDSIT për të biseduar lidhur me atë, ose me formu si komision ne si kuvend dhe me marr jo vetëm me rastin konkret por me u marr edhe me raste tjera. Ne si grup jemi kundër kësaj kërkesë, na vjen keq që ata qytetarë janë në atë gjendje por komuna nuk është një thesar me shpërnda mjete kush do që kërkon, sidomos te KEDS-i që është një kompani profitabile. Është obligim i KEDS-it me dërgu rrjetin atyre qytetarëve.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Limaj (anëtar nga LDK): Tek KEDS-i duhet me i bërë një presion. Me dasht me i vendos 5 bandera për 5 shpi duhet me shku me marr leje, të shkojnë 1500E vetëm planin se ku do të vendosen ata bandera. Pas bërjes së planit duhet me marr një kompani private për me i sjellë banderat dhe rrymën në ato pika. KEDS-i është duke i shkatrruar qytetarët tanë. Vetëm nëpër këto kanale qa janë duke bërë është tmerr, janë duke punuar pa kurrfarë kontrole. Unë kërkoj nga kryetari dhe asambleistët të marrim një vendim sepse ato familje kanë nevojë për ndihmë. Nëse komuna, kryetari nuk arrijnë një marrveshje ne duhet ti mbështesim 100%.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëlinda!

Mirëllinda Gashi (anëtare nga PDK): Unë kisha propozuar që kjo kërkesë e këti qytetari, sot ne të gjithë ta votojmë dhe me ia dërgu kryetarit në zyre dhe ta shoh që në komunën e tij ka qytetarë që jetojnë pa energji elektrike, sepse sot është problem me jetu pa energji elektrike.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Ne e dimë që komuna e Malishevës as nuk prodhon rrymë por as nuk e menaxhon rrjetin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, por e ka një kompani me emrin KEDS. Ne ndjejm keqardhje dhe jemi të shqetësuar pse ata qytetarë janë pa rrymë, por nuk janë për fajin tonë pa rrymë. Askush nga ne nuk ke kundër ndihmës ndaj tyre, por ne po themi që të krijojm hapsirë për të bërë presion tek ai që e ka obligim e që inkason mjete për të dërguar rrjet. Nuk është punë e jona, por është e KEDS-it dhe duhet ti bëhet presion. Unë propozoj që të lëjmë hapsirë deri në mbledhjen e ardhshme me kusht që Kryesuesi dhe Kryetari i komunës me thirr në një takim drejtorin e KEDS-it dhe me diskutu seriozisht këtë qështje.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Proceduralisht si kanë me u derdh ato mjete në llogarin e tyre, si subvencion apo si çka?

Si do ti ekzekutoj Drejtoria e Financave ato mjete?

Procedurat e tilla, punët e tilla, ai është investim kapital duhet të shkojnë përmes proceduarave të prokurimit publik sepse paran publike nuk mundesh me shfrytëzu siç të teket ty sepse janë disa procedura janë disa rregulla. Nuk është e vërtetë që komplet në atë lagje nuk ka energji elektrike, aty është një defekt tjetër dhe nuk e kanë pasqyru gjendjen reale qysh e kanë bërë kërkesën. Në kërkesë nuk është pasqyru gjendja faktike aty si është. Personi i cili e ka adresu kërkesën së paku qe 7 vite është në Malishevë dhe nuk ka shance që qe 7 vite me ka pa rrymë. Ta kemi parasysh për qka po e ngritim dorën dhe të jemi të arsyshëm.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina (anëtar nga LDK): Kjo kërkesë ju ka drejtuar zyrës së kryetarit që ka kërkuar që këtë problem ta zgjidh kryetari dhe ne nuk po ja lejmë vetëm kryetarit ta zgjidh këtë problem por po kërkojm që kryetari bashkë më ty kryesues dhe ne si asambleistë ti japim zgjidhje që qytetarët e Malishevës mos të jesin pa energji elektrike. Qytetarët e komunës së Malishevës janë më të durueshmit sa i përket shkeljeve që i bëhen me energji elektrike nga KEDS-i, sidomos në sezon të dimrit dhe verës. Për këtë duhet një zgjidhje ose një protest të madhe nga gjithë qytetarët e Malishevës që të shkojnë para KEDS-it. Sherri më i madh këtu është Kedsid dega në Malishevë, sepse ata kanë probleme të brendshme dhe pasojat i vuajn qytetarët. Ka shumë qytetarë që ballafaqohen me këto probleme. Për një orë elektrike KEDS-i për inate personale ta vanon dy muaj.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Gjithsecili nga ne pajtohet që gjendja në komunën e Malishevës është katastrofale, uroj që kjo të kaloj dhe gjendja me energji të përmirësohet. Kërkesa e cila ka ardhur përmes zyrës së kryetarit është mirë që ne të gjithë bashkë dhe të bëjmë një presion të madh tek zyret e KEDS-it në të gjitha format, sepse dëmet të cilat po i shkaktojnë gjatë mungesës së energjisë elektrike janë shumë të mëdha si tek bizneset ashtu dhe për ekonomi familjare. Unë ju kisha lutur që të kemi një mobilizim më të madh sa i përket kësaj qështje. Ne si PDK-ë do ti bashkohem qfarëdo mënyre si protest, peticion që duhet që të bëjmë presion. Para një vit e gjysme një protes që është organizu kemi marr pjesë pesë protestues që ka qenë qesharake, prandaj duhet të ketë mobilizim prej të gjithë neve që ta rrisim presionin tek ata.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Lima (anëtar nga LDK): Nëse kryetari nuk i ndihmon financiarisht, ai duhet të merret të shkojë sipas procedurave dhe me i ndihmu ata sepse kur po ngjiten disa bandera ose trafo po thoni na i kem ngjit. Bizneset janë shumë të dëmtuara sepse 7 orë janë pa rrymë. Unë kërkoj që kryetari të shkojë të bisedoj dhe ta bëjnë me reduktime 5/3 dhe jo gjithë ditën pa energji elektrike.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi (anëtar nga LDK): Nëse i referohemi ofertës, nëse gjatë kyqjes së gropave qëllon beton qmimi 70E për m2, gjithashtu në ofertë janë të llogaritur vetëm linjat kryesore dhe jo kyqja. Realisht nëse e votojmë këtë ne po i ndihmojmë KEDS-it dhe jo qytetarit. Ne rrymë nuk prodhojmë, KEDS-i është pronar dhe ky duhet ta ketë interesin sepse fiton prej tyre, nëse ja merr mjetet duhet ta kryej dhe shërbimin. Në Kijevë jemi me shtylla të viteve të 70-ta, kërkesa kemi të vazhdueshme. Presioni duhet të jetë dhe nga ne dhe nga kryetari dhe me zgjidh problemin për secilin qytetar që ka problem.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): I nderuar Hamit, komuna ka zot shtëpije dhe ai është Ekrem Kastrati, për këtë mandat që ja ka dhënë votën qytetari. Ka shtylla që i financon komuna, Labi shumë mirë e ceki që ky rrjet i shkon kompanisë dhe jo atyre klientëve. Kur është dashur kryetari të bëjë protest, as ti dhe as unë nuk kemi shkuar në protestë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Propozimi dhe opinioni i të gjithëve ishte që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, deri sa të bëhet presion nga kryetari, kryesusi dhe asambleja dhe nëse nuk trajtohet nga KEDS-i atëherë me rishqyrto edhe një herë në kuvend. Kush është për shtyrjen e kësaj pike? Me vota unanime të 19 anëtarve kjo pikë shtyhet për një mbledhje të radhës.

Pika e gjashtë

Raporti për barazi gjinore. Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Komiteti për barazi gjinore ka mbajtur gjithsej 4 takime, të gjitha takimet janë përmbajt planit të punës. Ky komitet rekomandon që do të mbështeten nisma të grave që merren me veprimtari të ndryshme ekonomike, të kemi mbështetje për prindërit vetëushqyes, mbështetje financiare për gratë e prekura nga kanceri, mbështetje për rastet e dhunës në baza gjinore dhe dhunë në familje, përkrahje më të madhe me buxhet për zyrën për barazi gjinore, përfshirjen në ndarjen e çmimeve të 16 qeshorit, gjithashtu është kërkesë që të përfshihen dhe gratë e komiteteve pakicë në këto aktivitete. Rekomandime për investime të mëtejme për arsim dhe trajnime për gratë në fusha të ndryshme duke përfshirë arsimin bujqësor teknologjin e informacionit dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për të hyrë në tregun e punës.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): I nderuar Helshani, ju përgëzoj për aktivitetin që e bëni dhe këto rekomandime që i dhe uroj që edhe ky kuvend, kryetari, dhe qeveria me i pëekrahë sa më shumë gratë sepse perspektiva e këti vendi është vetëm në qofse i përkrahemi gratë dhe ato janë të pavarura për zhvillimin e aktivitetit të tyre.

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Deshta që ti falënderoi dy gra të cilat kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm në shëndetsi dhe këtë nderë e ka bërë kuvendi sot.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e komitetit për barazi gjinore? Me vota unanime të 19 anëtarëve miratohet raporti për barazi gjinore

Kalojmë tek pika të ndryshme. Urdhëro, Amrush!

Amrush Helshani (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Së pari dua ti uroj qytetarët e komunës së Malishevës për ditën e Çlirimit dhe dëshmorëve të komunës së Malishevës. Unë e kam një kërkesë që nesër kur të mbahet seanca, të paktën anëtarët e asamblesë të kenë vende e rezervuara në seancë solemne.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati (antarë nga PDK): Ne nesër e kemi seancën solemne dhe në hymje më ranë në sy flamujt ishin në gjendje katastrofale. Kryesues, thirri organet kompetente dhe le ti vendosin flamujt ashtu siç i ka hije sepse ishin shumë të dëmtuar.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro Valon!

Valon Mazreku (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Urojë gjithë qytetarët e komunës së Malishevës. Është mirë që nesër të marrim pjesë në ditën e Çlirimit është mirë që në datat historike që në të marrim pjesë.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Urdhëro, Urim!

Urim Thaçi (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë kërkoi nga asambleja komunale që ta thirr në intërpelancë drejtorin e hidroregjionit në Malishevë në seancën e ardhshme.

Kryesuesi Argjend Thaçi: Ju faleminderit për prezencën. Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Përfundoi në ora:15:05

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi:

